REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
Njësia Org. 01 Nr.Prot. 4508
Nr. i faqeve 1 Data. 11.06.2012
Prishtinë / a

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë*
*Ministarstvo Trgovine i Industrije- Ministry of Trade and Industry*
*Kabineti i Ministres - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minester*

---

Prishtinë, 11.06.2012

Ministrja e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 19 të Ligjit Nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe, nenit 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 Për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 dhe Shtojcës 8 të Rregullores Nr. 02/2011 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive merr:

**VENDIM**
**PËR MARRJEN E MASAVE TË PËRKOHSHME MBROJTËSE**

I. Vendosen masat e përkohshme mbrojtëse në importe të çimentos për të gjitha vendet me tarifa prej 35%.

II. Bazuar në raportin e vlerësimit të dalur nga Departamenti i Tregtisë për vlerësimin e masave në import të datës 08.06.2012, obligohet Dogana e Kosovës që t'i ndërmarrë të gjitha masat përkatëse për të aplikuar tarifën në masën prej 35% për importin e çimentos për të gjitha vendet.

III. Vendimit i bashkëngjitet raporti për vlerësimin e masave mbrojtëse në importe.

IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Mimoza KUSARI-LILA**

**Ministre e MTI-së**

**Vendimi i dërgohet:**

- Sekretares së Përgjithshme;
- Dogana e Kosovës;
- SHPK SharrCem;
- Arkivit të MTI-së.